

Tiranë, më 05.11.2020

## AKT THEMELIMI

i shoqërisë tregtare "**CLIMA POINT ALBANIA**" SHPK

Sot më datë 05.11.2020, mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe në ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tij te lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akti themelimi nga Ortaku i Vetëm:

Znj. **Eliona QYTYKU**, e bija Bashkim-it, e datëlindjes 18.05.1977, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, Rruga: Muhamet Gjollësia, Njësia Bashkiake Nr.7, shtetase shqiptare, madhore, me zotësi juridike për të vepruar me dokument identifikimi ID. Nr 036216320.

### Formulimi

Neni 1

Formohet shoqëria tregtare private me përgjegjësi të kufizuar për të ushtruar veprimtari ekonomike e quajtur "**CLIMA POINT ALBANIA**" SHPK.

Shoqëria do t'i nënshtrohet legjislacionit shqiptar. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

### Selia e Shoqërisë

Neni 2

Shoqëria tregtare private "**CLIMA POINT ALBANIA**" SHPK do të ketë selinë e saj, në Rruga Egnatia, Km.7, Godina Nr.18, Kashar, Tiranë. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve.

### Objektivi i Veprimtarisë

Neni 3

Shoqëria tregtare private "**CLIMA POINT ALBANIA**" SHPK ka si objekt veprimtarie:

- Import - eksport, tregtim të artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me shumicë dhe pakicë si: industriale, ushqimore, bujqësore, fruta-perime, cigare të llojeve të ndryshme, pije alkolike, freskuese. Tregtim automjetesh të çdo lloji dhe tonazheve të ndryshme. Transport mallrash të ndryshme. Tregtim të pajisjeve elektrike, elektronike, kondicionerë, ngrohje-ftohje. Hapje hotelesh dhe restorantesh, lavazhe, servise. Tregtim të karburanteve të ndryshme me pakicë si dhe vajrave lubrifikante të gazit të lëngshëm, mbushje të bombolave të gazit dhe tregtim të tyre me pakicë.

-Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë që nuk bie ndesh me ligjet shqiptare në fuqi.

### **Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

### **Kapitali i Shoqërisë**

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqërisë private "**CLIMA POINT ALBANIA**" SHPK do të jetë **100,000 (njëqind mijë) Lekë**. Kapitali është 100% e ortakut të vetëm, e ndarë në 1 kuotë.

Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakësohet (por jo në vlerën e kapitalit themeltar fillestar).

### **Drejtimi i Shoqërisë**

Neni 6

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj dhe përfaqësuesi ligjor i saj. Ai është përfaqësuesi i shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj. Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve të shoqërisë.

Neni 8

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 9

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me logon dhe tekstin brenda saj.

Neni 10

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet dhe rregullat që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

Çështjet që nuk trajtohen në këtë akt themelimi, rregullohen në Statutin e Shoqërisë si dhe në legjislacionin përkatës shqiptar.

Neni 11

Akti i themelimit, u perpilua në 3 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "**CLIMA POINT ALBANIA**" SHPK.

Akti i themelimit u nënshkrua rregullisht nga ortaku i vetëm shoqërisë.

**Ortaku i Vetëm i Shoqërisë**

**"CLIMA POINT ALBANIA" SHPK**

Eliona QYTYKU

